



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i Lëndës: KSC-CA-2024-03

Vendos: Kryegjykatësja e Panelit të Dhomës së Gjykatës së Apelit
Gjykatëse Mishelë Pikar

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 4 shtator 2024

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës Para Apelit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:	Mbrojtjes së Pjetër Shalës:
Kimberli P. Uest	Zhan-Lui Zhilisen
 Mbrojtësit të Viktimave:	
Sajmon Loz	

KRYEGJYKATËSJA E DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Kryegjykatësja” dhe “Dhomat e Specializuara”, përkatësisht),¹ duke vepruar në pajtim me nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), lëshon këtë Urdhër.

1. Më 16 mars 2021, z. Pjetër Shala (“Shala” ose “i akuzuari”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës² dhe më 15 prill 2021 u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.³

2. Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues lëshoi aktgjykimin (“Aktgjykimi”), duke e shpallur të akuzuarin fajtor për tri pika të Aktakuzës dhe të pafajshëm për një pikë, dhe e dënoi atë me një dënim të vetëm prej 18 vite burg, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁴

3. Më 24 korrik 2024, Paneli i Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e të akuzuarit për shtyrje të afatit për dorëzimin e njoftimit të tij të apelit kundër Aktgjykimit dhe e urdhëroi atë që këtë ta bënte deri më 2 shtator 2024.⁵

¹ F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 3 shtator 2024 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 4 shtator 2024).

² KSC-BC-2020-04, F00013, Njoftim i Arrestimit të Pjetër Shalës sipas Rregullës 55(4), 16 mars 2021 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, riklasifikuar si publik më 29 prill 2021).

³ KSC-BC-2020-04, F00019/RED, Versioni i redaktuar publik i Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit, parashtrimi i protokolluar F00019 i datës 15 prill 2021, 26 prill 2021 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 15 prill 2021, riklasifikuar si konfidencial më 29 prill 2021).

⁴ KSC-BC-2020-04, F00107/A01, Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Korrigjuar, 16 nëntor 2021; KSC-BC-2020-04, F00098/A01, Aktakuza e Korrigjuar, 1 nëntor 2021 (konfidenciale) (“Aktakuza”); KSC-BC-2020-04, F00847, Aktgjykimi dhe Dënimi, 16 korrik 2024 (konfidencial) (“Aktgjykimi”), para. 1121-1125. Trupi Gjykues e shpalli fajtor Shalën për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës, por e shpalli të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte sipas pikës 2 të Aktakuzës. Shih Aktgjykimin, para. 1124. Shih gjithashtu, KSC-BC-2020-04, F00843, Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Aktgjykimit, 9 korrik 2024.

⁵ F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin nga Mbrojtja të Njoftimit të Apelit, 19 korrik 2024; F00006, Vendim mbi Mocionin Urgjent të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 24 korrik 2024 (“Vendimi mbi Ndryshimin e Afatit”). Më 8 gusht 2024, Paneli i

4. Më 2 gusht 2024, sipas udhëzimeve të Panelit të Apelit, Zyra Administrative raportoi për ecurinë e përkthimit në shqip të Aktgjykimit dhe vuri në dukje se përkthimi i parashikuar pritej të ishte gati deri më 6 shtator 2024, ndërsa përkthimi zyrtar deri në fund të tetorit 2024.⁶

5. Më 2 shtator 2024, i akuzuari dorëzoi njoftimin e tij të Apelit kundër Aktgjykimit ("Njoftimi i Apelit").⁷

6. Rregulla 178 e Rregullores parasheh që:

Brenda njëzet e një (21) ditësh nga njoftimi për apel, dhe kur çmohet e nevojshme pas kësaj, kryegjykatësi i panelit ose gjykatësi raportues nëse është caktuar, thërret një konferencë për t'i mundësuar çdo personi të paraburgosur në pritje të apelit të ngrejë çështje lidhur me apelin, përfshirë edhe lidhur me gjendjen mendore dhe fizike të personit.

7. Rrjedhimisht, Kryegjykatësja cakton mbajtjen e një konference para Apelit të **premtën, 20 shtator 2024, ora 10:00.**

8. Gjatë seancës, Kryegjykatësja fton palët, mbrojtësin e viktimave dhe/ose Zyrën Administrative, sipas rastit, të bëjnë parashtrime lidhur me:

- (i) Mbajtjen e të akuzuarit në paraburgim në pritje të apelit, duke përfshirë gjendjen e tij mendore dhe fizike, në pajtim me rregullën 178 të Rregullores;
- (ii) Çdo përditësim të mëtejshëm lidhur me ecurinë e përkthimit të Aktgjykimit në shqip, dhe përfundimin e tij të pritshëm; dhe

Apelit hodhi poshtë një kërkesë shtesë nga Shala për ndryshimin përsëri të afatit për dorëzimin e njoftimit të apelit, dhe konfirmoi që palët duhet t'i dorëzonin njoftimet e tyre të apelit, nëse kanë, deri më 2 shtator 2024. Shih F00009, Vendim mbi Kërkesën e Mëtejshme të Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 8 gusht 2024, para. 8. Shih gjithashtu, F00008, Kërkesë e Mbrojtjes për Shtyrjen e Mëtejshme të Afatit për Dorëzimin e Njoftimit të Apelit, 7 gusht 2024.

⁶ F00007, Përditësim i Administtores lidhur me Përkthimin e Aktgjykimit, 2 gusht 2024, para. 1. Shih gjithashtu, Vendimi mbi Ndryshimin e Afatit, para. 7, 13.

⁷ F00010, Njoftim i Mbrojtjes për Apelim, 2 shtator 2024 (konfidencial) ("Njoftimi i Apelit").

(iii) Çdo çështje tjetër që Kryegjykatësja mund të dojë të ngrejë.

9. Kryegjykatësja udhëzon palët dhe mbrojtësin e viktimave ta informojnë atë dhe palët e tjera dhe mbrojtësin e viktimave me postë elektronike, deri të **hënën, 16 shtator 2024, në orën 12:00**, për ndonjë çështje tjetër që ata do të donin të ngrinin gjatë Konferencës para Apelit.

10. Në pajtim me rregullat 96(2) dhe 173(3) të Rregullores, Kryegjykatësja udhëzon mbrojtjen ta njoftojë Njësinë për Administrimin e Gjykatës me postë elektronike deri të **hënën, 16 shtator 2024, ora 12:00**, nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në Konferencën para Apelit dhe/ose nëse i akuzuari dhe/ose mbrojtësi dëshirojnë të komunikojnë përmes videokonferencës. Në qoftë se i akuzuari nuk dëshiron të marrë pjesë në Konferencën para Apelit, Mbrojtja duhet të paraqesë parashtrimet përkatëse për mospjesëmarrje në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën ditë.

11. Rrjedhimisht, Kryegjykatësi i Panelit të Gjykatës së Apelit:

CAKTON Konferencën para Apelit për të **premtën, 20 shtator 2024, ora 10:00**;

URDHËRON Mbrojtjen të tregojë, deri të **hënën, 16 shtator 2024, ora 12:00**, dhe në mënyrën e përcaktuar më lart në paragrafin 10, nëse i akuzuari dëshiron të marrë pjesë në Konferencën Para Apelit dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë parashtrimet përkatëse për mospjesëmarrje; dhe

URDHËRON palët dhe mbrojtësin e viktimave të njoftojë Kryegjykatësen dhe palët e tjera dhe mbrojtësin e viktimave me postë elektronike deri të **hënën, 16 shtator 2024, ora 12:00**, për çdo çështje tjetër që ata do të donin të ngrinin gjatë Konferencës para Apelit.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E mërkurë, 4 shtator 2024

Në Hagë, Holandë